

KOMUNA E ISTOGUT 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Komuna e Istogut udhëhiqet nga kryetari Haki Rugova nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Rugova e ushtron funksionin e Kryetarit të Komunës nga muaji maj i vitit 2010, apo pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme pas vdekjes në detyrë të kryetarit Fadil Ferati. Edhe në zgjedhjet e vitit 2013, Haki Rugovës i është dhënë besimi i qytetarëve edhe për një mandat.

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetarë kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.¹ Sipas UNDP-së, 84% e qytetarëve të Istogut besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga probleme me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.² Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Istogut me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka një rënie të kënaqshmërisë nga 26 pikë në vitin 2012 në 15.54 në vitin 2015.³

Vlerësimet e bëra nga Instituti GAP në fund të vitit 2013 tregojnë se problemet kryesore në atë kohë në këtë komunë kanë qenë mungesa e sistemit të ujësjellësit dhe ujit të pijes, derdhja e kanalizimit në "Lumbardh", prerja e pyjeve, mos zhvillimi i turizmit dhe mbeturinat. Disa nga këto probleme janë eliminuar gjatë këtij mandati qeverisës.⁴

¹ Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

² UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr> (Hapur më 20 qershor 2017)

³ Ibid. faqe 40

⁴ Instituti GAP, Komuna e Istogut: problemet kryesore dhe trendët buxhetor. Burimi: <http://bit.ly/2rUMhwi>

Problemet aktuale të Komunës së Istogut

Derdhja e kanalizimit në “Lumbardh”

Të gjitha kanalizimet derdhen në shtratin e lumit që përshkon pjesën më të madhe të brendisë së qytetit të Istogut. Në disa pjesë, rrjedha e lumit kundërmon, shkak i derdhjes së kanalizimeve. Qyteti i Istogut nuk i ka të ndarë gypat e ujërave të zeza prej gypave të ujërave atmosferikë. Komuna e Istogut ka qenë ndër komunat e para në Kosovë që para viteve '90-ta ka pasur impiant për trajtimin e ujërave të zeza të vendosura në Banjicë. Asnjëri nga këta dy impiantë nuk është funksional që nga viti 1999. Sipas raportit të MAPL-së, vetëm 31.66% e ekonomive familjare janë të kyçura në sistemin e kanalizimit.⁵

Prerja e pyjeve

Pyjet e rajonit të Istogut prehen vazhdimisht. Nga prerja ilegale e pyjeve nuk kursehen as zonat të cilat konsiderohen si atraksion natyror të kësaj komune si “Lugu i Zymit”. Rajonet më të prekura nga ky fenomen janë Lugu i Zymit, Mokna, Radusha, Lugu i Butë.

Mos-promovimi i turizmit malor

Komuna e Istogut njihet për bukuritë natyrore dhe potencialin që ka për zhvillimin e turizmit malor. Bjeshkët e Nemuna dhe malet e Mognës janë disa nga resurset kryesore për zhvillimin e turizmit. Mirëpo mungon promovimi i turizmit. Istogu është i njohur edhe si vend me trashëgimi kulturore ku përafërsisht janë të evidentuara rreth 28 vendndodhje arkeologjike si në Studenicë, Vrellë, Bojnicë dhe Surriganë.

Rrjeti i ujësjellësit në zonat rurale dhe mungesa e ujit të pijes gjatë verës

Edhe pse ka pasur përmirësime në rregullimin e rrjetit të ujësjellësit në disa fshatra të komunës së Istogut, ky problem akoma nuk është zgjidhur për fshatrat Cërkolez, Syrigane, Polan, Padalishtë, Suhogërrllë dhe një pjesë e fshatit Kerrninë. Sipas bashkëbiseduesve, problem tjetër është edhe mungesa e ujit në disa fshatra të komunës gjatë muajve të verës si në Vojdullë, Kaliqan, Kovragë, Rakosh, Staradran, Uçë, etj. Sipas Mozaikut të UNDP-së 2015, 55% e qytetarëve janë të kënaqur me furnizimin me ujë.⁶

Mbeturinat dhe mungesa e deponive

⁵ MAPL, Raporti i Performancës së Komunave 2015, fq. 59, Burimi: <http://bit.ly/2tsJEE6>

⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 86. (Hapur më 20 qershor 2017)

Prezenca e deponive të egra është problem për qytetarët e Istogut. Deponitë e mbeturinave gjenden në fshatrat Llukac i Begut, Rakosh, Dubravë, Lubozhd, etj. Edhe pse në fshatin Tupec ekziston deponia e vjetër, kjo deponi nuk i plotëson kushtet dhe nuk ka pasur ndonjë investim përveç se është hapur edhe një gropë afër saj nga ana e komunës.

Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje

Zhvillimi i turizmit

Komuna e Istogut vlerësohet me potenciale të mira për të zhvilluar turizmin, veçmas atë malor. Komuna ka një muze ku prezantohen artefakte të ndryshme, por është pak i njohur në opinion. Komuna do të duhet të përpilonte një program të turizmit kulturor dhe gradualisht Istogu të bëhej një destinacion i turistëve.

Zhvillimi i bujqësisë

Krahas turizmit, Istogu ka potenciale të mira për zhvillimin e bujqësisë, veçmas në pemëtari dhe vreshtari. Në vitet e fundit janë vërejtur lëvizje pozitive në këtë drejtim, por akoma kjo kulturë nuk ka një shtrirje të gjerë. Komuna do të duhet të organizonte trajnime dhe takime të ndryshme me qëllim të inkurajimit të zhvillimit të kësaj sfere.

Trendet buxhetore në Komunën e Istogut(2017)

Komuna e Istogut në vitin 2017 ka planifikuar 9.4 milion euro buxhet.⁷ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe 413 mijë euro të tjera nga të hyrat vetanake të shpenzuara.⁸ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013⁹, Komuna e Istogut ka pasur një rritje prej 1 milion euro të buxhetit. Kjo rritje në masë të madhe buron nga rritja e granteve qeveritare.


⁷ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2tNdtOP> dhe Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

⁸ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63 (hapur më 6 shtator 2017).

* Në këtë vit mjetet e bartura nga të hyrat e pa shpenzuara ishin më të ulëta se në 2017 për rreth 245 mijë euro. Shih Raportin vjetor financiar 2012. Ministria e Financave. Burimi: <http://bit.ly/2wKArJf>, faqe 60 (hapur më 6 shtator 2017).

⁹ Shih Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Istogut 2017




Rritja e buxhetit krahasuar 2017 me kohën e zgjedhjeve të fundit (2013) është bërë në kategorinë e pagave, investimeve kapitale dhe mallrave dhe shërbimeve. Në buxhetin e vitit 2017 janë ndarë rreth 1.4 milionë euro më shumë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve (5.8 milionë euro) se në 2013, ndërsa janë reduktuar kategoria e subvencioneve (224 mijë euro) dhe ajo e shpenzimeve kapitale (2.4 milionë euro) për rreth 200 mijë euro. Ndikim të madh në rritjen e buxhetit për paga kishte vendimi i Qeverisë së Kosovës i vitit 2014 për rritjen e pagave në sektorin publik për 25%.¹⁰ Po ashtu, angazhimi i 22 punonjësve të rinj¹¹ në periudhën 2013-2016 ka bërë që shpenzimet për paga të rrisin pjesëmarrjen e tyre në buxhetin vjetor të komunës. Kurse në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, shuma e planifikuar në vitin 2017 (853 mijë euro) është e njëjtë me atë të vitit 2013.

¹⁰ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M> (hapur më 6 shtator 2017).


¹¹ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj> (hapur më 6 shtator 2017).

Figura nr.2: Trendët buxhetore të Istogut më 2013 dhe 2017



Të hyrat vetanake të Istogut kanë pasur ngritje të vazhdueshme përgjatë katër viteve të fundit. Më e potencuar ishte ngritja në vitin 2014, ku për dallim nga viti paraprak të hyrat u rritën për 21%.¹² Gjatë vitit 2016, Istogu ka realizuar rreth 1.1 milion euro të hyra, ku kontribuesja më e madhe mbetet kategoria e tatimit në pronë (43%). Por, kategori e rëndësishme e të hyrave vetanake mbetet edhe ajo e taksave komunale për leje ndërtimi.¹³

Figura nr.3: Të hyrat komunale të Istogut, 2013-2016



Burimi: Zyra e Auditorit të përgjithshëm

¹² Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Istogut 2016. Burimi: <http://bit.ly/2gKpDn0> (hapur më 6 shtator 2017).

¹³ Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2016 për Komunën e Istogut. Burimi: <http://bit.ly/2eJDwkQ> (hapur më 6 shtator 2017).

Krahasuar me vitin 2017, sipas vlerësimeve në ligjin për buxhetin 2017¹⁴, buxheti i Komunës së Istogut pritet të rritet rreth dy përqind më 2018 (9.6 milionë euro) dhe 2019 (9.8 milionë euro). Istogu planifikon që ta ulë mbështetjen buxhetore në sektorin e bujqësisë për mbi 30% deri më 2019 dhe të trefishojë buxhetin për planifikimin urban dhe mjedisin.

Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Istogut duhet të bëjë zgjidhjen e problemit të ujerave të zeza, veçmas evitimin e problemit të derdhjes së këtyre ujerave në lumin e qytetit.
- Komuna e Istogut duhet të ndërmarr masa më rigorozë ndaj prerjes ilegale të pyjeve.
- Komuna e Istogut duhet të investojë në projekte që do të promovonin dhe zhvillonin turizmin e kësaj ane.
- Komuna e Istogut duhet të gjejë burime të reja të ujit me qëllim të furnizimit të vendbanimeve që kanë mungesë të ujit të pijes.
- Komuna e Istogut duhet të vendos shporta të mbeturinave në qytet dhe të gjejë një lokacion për hedhjen e mbeturinave.

¹⁴ Ligji Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, faqe 251.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world